Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/779
Datë: 01.12.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Riakreditohet** dhe **rivalidohet** institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK), për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 15.07.2022 deri 14.07.2026, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK);

   1.1 **Teknik i Blegtorisë, Niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional, me 12 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në tre grupe brenda një vit kalendarik me nga 15 kandidat në grup.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK), për riakreditim të institucionit dhe rivalidimi të kualifikimit me adresë: Fshati Sfaraçak i Ulët, nr.11, 42000 në Vushtrri, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK sipas legjislacionit në fuqi.
Ekipi i Eksperteve me datë 18.10.2023 ka bërë shqyrtimin e dokumentacionit nga dosja e aplikimit, ndërsa me datë 20.10.2023 ka realizuar vizitën në këtë institucion.
Pas realizimit të vizitës nga ekipi i ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve me datë 06.11.2023 ka hartuar raportin përfundimtar dhe ka dhënë vlerësim pozitiv sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve nga ana e institucionit, të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe certifikues; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës së institucionit Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK), për riakreditim dhe rivalidim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhënë në raportin e vlerësimit për këtë institucion, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës"
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së